



Pranuar / Dorezuar Prilijena/Prodato Received/Delivery	26.07.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojc Pajlog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KPMSHCK	5367	2023	1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.902/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.902/2023, të datës 03.07.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministria e Industrisë Nderrmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.07.2023, mori këtë.

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.902/2023 e datës 03.07.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 03.07.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4997/2023 të regjistruar nën shenjen A.nr.902/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompozimin e ditëve të pashfrytëzuara të pushimit vjetor të vitit 2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 03.07.2023, për mes e-mailit ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Industrisë Nderrmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa nga kjo e fundit, me datë 07.07.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me këtë çështje ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankesa A.nr.902/2023 e datës 03.07.2023, është e palejuar, sepse:

Nga provat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimi me numër reference: Ref.03/ Nr. 05 i datës 24.10.2022 është konstatuar së ankuesi është i punësuar në pozitën e punës "Inspektor i Tregut" në Ministrinë e Industrisë Ndermarrësisë dhe Tregtisë.

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar me datë 03.07.2023 pretendon që t'i njihet e drejta e kompensimit me të holla e ditëve të pashfrytëzuara të pushimit vjetor të vitit 2022, për arsye se nuk i është aprovuar pushimi nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi me datë 11.05.2023, ka bërë kërkesën për shfrytëzimin e pushimit vjetor në kohëzgjatje nga data 16.05.2023, deri me datën 29.09.2023, mirëpo kjo kërkesë nuk i është aprovuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt dhe për pasojë i njëjti me datë 03.07.2023, ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me kërkesë për njohjen e të drejtës për kompensimin e ditëve të pashfrytëzuara të pushimit vjetor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi për njohjen e të drejtës për kompensimin me të holla të ditëve të pashfrytëzuar të pushimit vjetor nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë zyrtarit kryesor administrativ në Ministrinë e Industrisë Ndermarrësisë dhe Tregtisë, si organ kompetent për trajtimin e kësaj çështje në kuadër të organit të punësimit, kështu që në rrethanat e rastit konkret nuk kemi veprim apo mosveprim nga udhëheqësi me i larte administrativ në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesi mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e tij, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.*

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit nuk ka të bëjë me lejimin e shfrytëzimit të pushimit vjetor, por me kompensimin në të holla të pushimit vjetor të pashfrytëzuar, kërkesë kjo e re e ankuesit, andaj si e tillë kërkesa për kompensim duhet të drejtohet fillimisht të organi i punësimit dhe vetëm pas veprimit të organit të punësimit apo heshtjes administrative të të njëjtit organit, ankuesi mund të parashtror ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kështu që për sa me sipër Kolegji i Këshillit vlerëson se ne rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet për pranueshmëri të ankesës, siç përcaktohet me nenin 129 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.902/2023

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Jeton Koca

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndermarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë Ndermarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.